

GREEN COAST SHPK

RRUGA "TISH DALJA", KOMPLEKSI KIKA 2, GODINA 3, KATI 1., TIRANE, SHQIPËRI

L41329038D

VENDIM

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më 29.12.2025, në orën 10.00, në selinë e Shoqërisë **Green Coast SHPK** (më tej referuar si "Shoqëria"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

- **Shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar pranë Regjistrat Tregtar e numër unik të identifikimit të subjektit K72223031K, me përfaqësues ligjore Znj. Edlira MUKA, përfaqësuar në këtë mbledhje nga ana e Z. Leons TUDA, shtetas shqiptar, lindur më 07.08.1992, në Shijak, mbajtës i pasaportës me nr. BE5028529, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, sipas Prokurës së Posaçme nr. 11150 Rep dhe nr. 8300 Kol date 24.12.2025 të noterit Ermal Xh. Hamzaj (këtu e në vijim referuar si "**Ortaku i Vetëm**"),

Z. Leons Tuda i cili merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton Znj. Brixhilda Kasa, këshilltare ligjore e shoqërisë, e cili pranon, të kryejë funksionin e sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

I. ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Kryetari parashtroi se kapitali aktual i Shoqërisë është **4,651,898,228.00 LEK (katër miliard e gjashtëqind e pesëdhjetë e një milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e dyqind e njëzet e tetë lekë)**.

Në kushtet kur veprimtaria e Shoqërisë ka përformuar kënaqshëm dhe situata financiare është në përputhje me pritshmëritë, është propozuar nga ana e Ortakut të Vetëm zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë në vlerën prej 1,200,000 Euro (një milion e dyqind mijë euro), e barasvlerëshme me shumën në LEK 115,752,000 (Njëqind e pesëmbëdhjetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e dy mijë lekë) sipas kursit të këmbimit 96.46 të publikuar nga Banka e Shqipërisë në datë 24.12.2025.

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Asambleja:

VENDOS:

- A. **Miratimin e zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë me vlerën 1,200,000 Euro (një milion e dyqind mijë euro), e barasvlerëshme me shumën në LEK 115,752,000 (Njëqind e pesëmbëdhjetë milion e**

shtatëqind e pesëdhjetë e dy mijë lekë)) sipas kursit të këmbimit 96.46 të publikuar nga Banka e Shqipërisë në datë 24.12.2025.

- B. Bazuar në sa më sipër zvogëlimi i kapitalit do të konsiderohet Kontribut ne Para dhe i shlyer plotësisht nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.
- C. Si rezultat i miratimit të Zvogëlimit të Kapitalit sipas pikave (A) dhe (B) më sipër, kapitali i Shoqërisë nga 4,651,898,228.00 LEK katër miliard e gjashtëqind e pesëdhjetë e një milion e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e dyqind e njëzet e tetë lekë), bëhet 4,536,146,228.00 LEK (Katër miliardë, pesëqind e tridhjetë e gjashtë milionë, e njëqind e dyzetë e gjashtë mijë, e dyqind e njëzet e tetë lekë).

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 10.30.

Ky procesverbal i Asamblesë së Ortakut të Vetëm të "Green Coast" SHPK mbahet në formën e procesverbalit, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

GREEN COAST SHPK

KRYETARI



Z. Leons Tuda

Përfaqësues me Prokurë i Administratorit të Ortakut

Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK



SEKRETARI



Znj. Brixhilda Kasa